

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6167
E martë, 17 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Instituti i Historisë i
reagon Speciales: Agresori
dhe viktima janë vënë në
pozita të barabarta | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5

ISH-DREJTUESIT E UÇK-së DO TË DALIN FAQEBARDHË

- UÇK-ja luftoi për liri,
s'ka aktakuzë që mund
ta ndryshojë këtë



Nënkryetari i Aleancës për
Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal
Lekaj, duke iu referuar aktakuzave të
Gjykatës Speciale kundër ish-
drejtuesve të UÇK-së, ka thënë se nuk
ka aktakuzë që mund ta ndryshojë
faktin se UÇK-ja ka luftuar për liri dhe
kundër represionit të Serbisë. Lekaj

është shprehur i bindur se Taçi,
Veseli, Selimi, Krasniqi dhe të tjerët
do të dalin faqebardhë edhe në
betejën me Specialet. "Pres që të
dalin faqebardhë ata dhe të gjithë ne,
UÇK-ja dhe Kosova. Nuk luftuam se
na pëlqen lufta, por sepse nuk patëm
dhe nuk na lanë zgjidhje tjetër. E

provuam me politikë paqësore dhe
negociata, ndërsa Beogradi u përgjigj
me dhunë, gjenocid dhe masakra",
është shprehur Lekaj. Ndërsa sa i
përket kërkesës së opozitës për
zgjedhje, Lekaj ka thënë se ato janë
opsione nëse nuk ka pajtueshmëri që
Ramush Haradinaj të bëhet president



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

I. LUFTA E USHTRISË ÇLIRIMTARE E KOSOVËS, PROPAGANDA SERBE DHE AKTAKUZAT KUNDËR UÇK-së | FAQE 5

HOTI: PAS PAK DITËSH FILLOJMË BISEDAT PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ZEMAJ: ASNJË MJEK NUK
DO TË MBETET I PAPUNË | F. 3

RAMA DHE KURZI BISEDOJNË
PËR INTEGRIMIN E SHQIPËRISË
NË BE | F. 2

DEPUTETI I KUVENDIT TË
SHQIPËRISË: TË BËHEMI BASHKË
DHE TA MIRATOJMË REZOLUTËN
PËR GJENOCIDIN SERB | F. 9

EKONOMI



PROTESTOJNË PUNËTORËT E
TELEKOMIT PAS BLOKIMIT TË
XHIROLLOGARIVE, KËRKOJNË
PËRGJEGJËSI NGA QEVERIA | F. 7

ZYRA LIGJORE E KUVENDIT
S'I JEP MANDAT KOMISIONIT
T'I PEZULLOJË LEJET PËR
HIDROCENTRALET | F. 7

NAFTËTARËT KËRKOJNË
SHFUQIZIMIN E UDHËZIMEVE TË
MTI-SË, THONË SE U
SHKAKTUAN DËME MILIONËSHE | F. 7

SPORT

FITORJA NDAJ BJELLORUSISË
IA SIGURON SHQIPËRISË
VENDIN E PARË NË GRUP DHE
MBI 1 MILION EURO | F. 15

Hoti: Integrimi i tregut, hapi i parë drejt pajtimit politik të rajonit

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka marrë pjesë në formë virtuale në Forumin Ekonomik të Vjenës me moton "Ekonomia takon politikën në botën digjitale". Hoti ka bërë me dije se në këtë forum është diskutuar kryesisht për nevojën për mobilizim të ri në botën digjitale, për sfidat dhe për mundësitë për ekonominë e rajonit. Ai ka thënë se integrimi i tregut është hapi i parë drejt pajtimit politik të rajonit. "Sot mora pjesë në Forumin Ekonomik të Vjenës, "Vjena, dialogu për të ardhmen 2020", me moton "Ekonomia takon politikën në botën digjitale". Në këtë forum u diskutua kryesisht për nevojën për mobilizim të ri në botën digjitale, për sfidat dhe për mundësitë për ekonominë e rajonit. Përkundër pandemisë Covid-19, Kosova ka vazhduar angazhimet konkrete për ta

realizuar agjendën evropiane, me theks të veçantë në Tregun e Përbashkët Rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Besoj fuqishëm se pas zotimeve në Samitin e Sofjes, javën e kaluar, integrimi i tregut është hapi i parë drejt pajtimit politik të rajonit. Qëndrueshmëria ekonomike dhe sociale është kyçe për zhvillimin afatgjatë dhe integrimin në BE të gjithë rajonit", ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se Kosova është e vendosur për të promovuar marrëdhënie të qëndrueshme ekonomike dhe politike me vendet e rajonit. "Presim qasje konstruktive nga të gjitha palët, sidomos nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina. Bashkëpunimi multilateral siç është Tregu i Përbashkët Rajonal, promovon dhe përmirëson sigurinë në rajon, qëndrueshmërinë politike dhe bashkëpunimin ekonomik", është shprehur Hoti.



Rama dhe Kurzi bisedojnë për integrimin e Shqipërisë në BE

VJENË, 16 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zhvilluar sot një video-konferencë me kancelarin e Austrisë, Sebastian Kurz. Me këtë rast, kancelari austriak ka thënë se me Ramën ka biseduar mbi luftën e përbashkët kundër terrorizmit dhe ekstremizmit, pandeminë Covid-19 dhe mbështetjen tonë për procesin e pranimit të Shqipërisë në BE. "Sapo pata një video-konferencë të mirë

me kryeministrin e Shqipërisë dhe kryetarin e Zyrës së OSBE-së, Edi Rama, mbi luftën e përbashkët kundër terrorizmit dhe ekstremizmit, pandeminë Covid-19 dhe mbështetjen tonë për procesin e pranimit të Shqipërisë në BE. Bashkimi Evropian do të jetë i plotë vetëm kur të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor t'i bashkohen atij", ka shkruar Kurzi në llogarinë e vet në "Twitter".



Rama: Kemi paguar kaparin për vaksinën kundër Covidit

TIRANË, 16 NËNTOR (ER) - Duke folur në Kuvend, kryeministri Edi Rama ka zbuluar se Shqipëria ka paguar kaparin te kompania "Covax" për vaksinën anti-Covid që pritet të përdoret në Shqipëri dhe në vende të tjera të Evropës. "Ndihma ekonomike do të jetë e dyfishuar. Sot qeveria shqiptare ka paguar edhe kaparin për 'Covax'. Ka hyrë në rrjetin e shteteve që kanë prenotuar financiarisht qasjen në vaksinë që pritet të

dalë për përdorim masiv në muajt që vijnë. Jemi në komunikim të përditshëm me BE-në. Kam pasur bisedë të gjatë me presidenten, disa nga kryeministrat për të garantuar qartësi dhe siguri për aksesin në vaksinimin e popullsisë, duke marrë parasysh se vaksina do të dalë për sasi të disponueshme. Nuk do ta mbulojnë menjëherë të gjithë popullsinë e Evropës", ka thënë Rama, duke shtuar se


kjo vaksinë do të shpërndahet falas. "Ne kemi të njëjtën strategji për vaksinimin falas te grupet vulnerabël dhe për t'i shtrirë të gjitha shtresat e shoqërisë. Sot jemi gati për të pasur akses dhe po punojmë për të pasur aleancat e duhura. Jam optimist që BE do të jetë gjithëpërfshirëse në strategjinë e vet për ta garantuar vaksinimin e popullsisë dhe Shqipëria do të jetë pjesë", ka deklaruar Rama.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 11 të vdekur, 236 të shëruar dhe 688 raste të reja

Shifra të larta të të vdekurve dhe të infektuarve me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit 11 persona e kanë humbur betejën me Covid, duke e ngrehur në 833 numrin e përgjithshëm të të vdekurve nga ky virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 688 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 236 persona. “Numri total i rasteve pozitive është 29 805 raste nga 120 811 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 833 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 236 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 17 541 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 11 431”, ka njoftuar IKShPK-ja



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur 11 persona si pasojë e infeksionit me Covid-19 dhe janë paraqitur 688 raste të reja me koronavirus. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 236 persona nga virusi “Korona”. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 865 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve

rezultojnë 688 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë 3 raste (76, 54, 38 vjeç), Rahovec 2 raste (74, 67 vjeç), Ferizaj 1 rast (48 vjeç), Gjilan 1 rast (82 vjeç), Kamenicë 1 rast (57 vjeç), Klinë 1 rast (65 vjeç), Skenderaj 1 rast (76 vjeç) dhe Suharekë 1 rast (54 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 29 805 raste nga 120 811 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 833 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 236 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 17 541 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 431”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë

Zemaj: Asnjë mjek nuk do të mbetet i papunë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një konferencë për media ka bërë me dije se nga sot (e martë) do të hapet konkursi i specialistëve të papunë në ShSKUK. “Sot do ta ndajmë lajmin e ri për specialistët e papunë. Kjo është ditë e madhe dhe është lajm i mirë për qytetarët dhe shëndetësinë e Kosovës. E konfirmojmë se specialistët po punësohen. ShSKUK-ja hap konkursin për specialistët e papunë. Nga sot nuk ka më asnjë mjek që do të mbetet në rrugë. Edhe në të ardhmen nuk do të lejoj që asnjë mjek të mbetet i papunë. Ky nuk ka qenë vetëm premtim, por zotim i Qeverisë së Kosovës”, ka thënë Zemaj.

me dije se vetëm në Prishtinë janë paraqitur 303 raste të reja me Covid. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 303 raste, Gjilan 39 raste, Prizren 38 raste, Vushtri 37 raste, Pejë 32 raste, Fushë-Kosovë 31 raste, Mitrovicë 31 raste, Ferizaj 22 raste, Lipjan 20 raste, Skenderaj 17 raste, Drenas 16 raste, Viti 16 raste, Obiliq 14 raste, Suharekë 13 raste, Kamenicë 8 raste, Gjakovë 7 raste, Klinë 7 raste, Malishevë 7 raste, Kaçanik 6 raste, Deçan 5 raste, Istog 5 raste, Shtime 5 raste, Podujevë 4 raste, Dragash 3 raste dhe Novobërdë 2 raste. Mbulojini gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Hoti: Pas pak ditësh fillojmë bisedat për çështjen e presidentit



PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se së shpejti do t'i nis diskutimet me partitë politike për pozitën e presidentit të vendit. Hoti ka thënë se beson që kjo çështje do të marrë udhë, ndërsa ka theksuar se do ta shohin mundësinë për ta kaluar këtë situatë. “Besoj se kjo çështje do të marrë udhë. Për disa ditë fillojmë bisedat me gjithë spektrin politik për të parë se si mund ta kalojmë këtë situatë. Rruga kushtetuese është e qartë. Besojmë në një zgjidhje që është më e mira për vendin”, ka thënë Hoti në një konferencë për media, pas vizitës që ka pasur në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Çështja e zgjedhjes së presidentit është aktualizuar pas dorëheqjes së Hashim Thaçit nga kjo pozitë për shkak të aktakuzës nga Gjykata Speciale. Pozita e presidentit të Kosovës është duke u ushtruar nga kryeparlamentarja Vjosa Osmani. Kujtojmë se kandidaturën për president e ka paraqitur lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.



FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

ISH-DREJTUESIT E UÇK-së DO TË DALIN FAQEBARDHË

- UÇK-ja luftoi për liri, s'ka aktakuzë që mund ta ndryshojë këtë

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, duke iu referuar aktakuzave të Gjykatës Speciale kundër ish-drejtuesve të UÇK-së, ka thënë se nuk ka aktakuzë që mund ta ndryshojë faktin se UÇK-ja ka luftuar për liri dhe kundër represionit të Serbisë. Lekaj është shprehur i bindur se Thaçi, Veseli, Selimi, Krasniqi dhe të tjerët do të dalin faqebardhë edhe në betejën me Specialen. "Pres që të dalin faqebardhë ata dhe të gjithë ne, UÇK-ja dhe Kosova. Nuk luftuam se na pëlqen lufta, por sepse nuk patëm dhe nuk na lanë zgjedhje tjetër. E provuam me politikë paqësore dhe negociata, ndërsa Beogradi u përgjigj me dhunë, gjenocid dhe masakra", është shprehur Lekaj. Ndërsa sa i përket kërkesës së opozitës për zgjedhje, Lekaj ka thënë se ato janë opsione nëse nuk ka pajtueshmëri që Ramush Haradinaj të bëhet president

procesit gjyqësor në Hagë.

Në këtë kontekst, ai është shprehur i bindur se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Salih Mustafa do të dalin të pafajshëm. "Pres që të dalin faqebardhë ata dhe të gjithë ne, UÇK-ja dhe Kosova. Nuk luftuam se na pëlqen lufta, por sepse nuk patëm dhe nuk na lanë zgjedhje tjetër. E provuam me politikë paqësore dhe negociata, ndërsa Beogradi u përgjigj me dhunë, gjenocid dhe masakra", ka deklaruar Lekaj, duke shtuar se mbrojtja e UÇK-së duhet të jetë në fokusin e të gjithëve. "Duhet ta mbrojmë atë sepse është e shenjtë, sepse është themeli i pavarësisë së Kosovës. Sigurisht se duhet bërë më shumë. Gjithmonë do të ketë hapësirë për të bërë më shumë, jo vetëm

sot, por për jetë e mot", ka thënë Lekaj.

Më tutje, Lekaj ka folur për kërkesën e opozitës që Kosova të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe propozimin e AAK-së që Ramush Haradinaj të jetë president. Lekaj ka thënë se qëndrimi i AAK-së është i qartë: ose Haradinaj president, ose vendi shkon në zgjedhje. "Qëndrimi ynë është i qartë, të biem dakord për ta zgjedhur presidentin. Nëse jo, zgjedhjet mbeten opsion. Nuk mund të lejojmë vakuum kushtetues", ka deklaruar Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, si i vlerësoni zhvillimet e fundit në Kosovë pas aktakuzave të Gjykatës Speciale kundër ish-drejtuesve të UÇK-së?

Lekaj: Aktakuzat e Gjykatës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, i ka quajtur të dëmshme për vendin dhe luftën çlirimtare

akuzat e ngritura kundër ish-drejtuesve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Pavarësisht kësaj, Lekaj në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se nuk ka aktakuzë që mund ta ndryshojë luftën e

drejtë të UÇK-së. "Ne luftuam për liri dhe të drejtat tona. Luftuan për t'i mbijetuar shtypjes dhe represionit. Nuk ka aktakuzë apo akuzë që të mund ta ndryshojë këtë", ka thënë ai. Lekaj ka vlerësuar se e vërteta e UÇK-së do të dalë në dritë gjatë





Speciale janë të dëmshme së pari për Kosovën dhe luftën e saj për liri dhe pavarësi, por liria dhe UÇK-ja kanë emër dhe ata që janë në Hagë janë pjesë e kësaj ushtrie, të një populli që po luftonte për të drejtat e veta. Jemi të sigurt se e vërteta e Kosovës, e vërteta e UÇK-së dhe e vërteta e tyre do të dalë në dritë të diellit ashtu siç ka dalë në rastin e Ramush Haradinajt më shumë se një herë, të Fatmir Limajt dhe të tjerëve.

“Epoka e re”: E keni lexuar aktakuzën kundër krerëve të UÇK-së? Cilat janë komentet tuaja në raport me këtë aktakuzë?

Lekaj: Nuk komentoj as aktakuza e as akuza ndaj UÇK-së. E vërteta historike mbetet ajo që ka qenë dhe është. Ne luftuam për liri dhe të drejtat tona. Luftuam për t'i mbijetuar shtypjes dhe represionit. Nuk ka aktakuzë apo akuzë që të mund ta ndryshojë këtë.

“Epoka e re”: Çfarë prisni nga procesi gjyqësor që është duke u zhvilluar në Hagë?

Lekaj: Pres që të dalë në shesh e vërteta. Pres që të dalin faqebardhë ata dhe të gjithë ne, UÇK-ja dhe Kosova. Nuk luftuam se na pëlqen lufta, por sepse nuk patëm dhe nuk na lanë zgjidhje tjetër. E provuam me politikë paqësore dhe negociata, ndërsa Beogradi u përgjigj me dhunë, gjenocid dhe masakra.

“Epoka e re”: Derisa në Hagë gjenden ish-presidenti, dy ish-krjeparlamentarë dhe shefi i grupit parlamentar i partisë më të madhe në vend, vlerësoni se institucionet dhe partitë politike janë në nivel të detyrës, kur është në pyetje mbrojtja e luftës çlirimtare?

Lekaj: Lufta çlirimtare duhet të jetë në fokus të të gjithëve. Duhet ta mbrojmë atë sepse është e shenjtë, sepse është themeli i pavarësisë së Kosovës. Sigurisht se duhet bërë më shumë. Gjithmonë do të ketë hapësirë për të bërë më shumë, jo vetëm sot, por për jetë e mot.

“Epoka e re”: Z. Lekaj, në këtë situatë a janë të favorshme zgjedhjet të cilat është duke i kërkuar opozita?

Lekaj: Opozita ka të drejtë të kërkojë atë që mendon se është zgjidhje e mirë sipas saj, ndërsa ne kemi qëndrimet tona. Duhet të bisedojmë me njëri-tjetrin për ta zgjedhur presidentin dhe AAK-ja e ka bërë tashmë propozimin e saj, Ramush Haradinajn.

“Epoka e re”: Prisni që partitë politike do të gjejnë një zgjidhje sa i përket postit të presidentit, apo zgjedhjet do të jenë të pashmangshme?

Lekaj: Qëndrimi ynë është i qartë, të biem dakord për ta zgjedhur presidentin. Nëse jo, zgjedhjet mbeten opSION. Nuk mund të lejojmë vakuum kushtetues.

INSTITUTI I HISTORISË I REAGON SPECIALES: AGRESORI DHE VIKTIMA JANË VËNË NË POZITA TË BARABARTA

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë ka reaguar pas konfirmimit të aktakuzave ndaj ish-drejtuësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të tjerëve nga Gjykata Speciale, duke thënë se gjenocidi i formës së organizuar kalohet në heshtje, ndërsa gjykohen ata që qenë detyruar ta organizonin vetëmbrojtjen kolektive të popullit të tyre në përpjekje sublime për liri. Sipas këtij instituti, lufta çlirimtare në Kosovë ishte e imponueshme, e domosdoshme dhe e drejtë, ngaqë ishte e drejtuar kundër një pushtuesi i cili përpiqej me zjarr dhe hekur ta kryente spastrimin e përgjakshëm etnik të Kosovës. “Çlirimtarët që sot po gjykohen në Hagë, kontribuuan përtej çdo pritjeje në rrethanat më të vështira të kohës, forcuan besimin dhe unitetin, duke vitalizuar dhe rritur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ngritën në këmbë një armatë çlirimtarësh, duke qenë kështu për ne, shenja e shenjtë e kujtesës sonë historike. Ata i dhanë popullit shqiptar besimin se mund të bëhet luftë çlirimtare kur ke zemër, kur ke të drejtë, kur je i gatshëm të sakrifikosh, kur je në gjendje ta dëshmosh të drejtën tënde dhe ta nxjerrësh pa maskë pushtuesin e huaj, ndërsa botës i dha mesazhin se shqiptarët nuk mund të qëndronin edhe më tej të shtypur e të maltretuar, në mbyllje të shekullit XX”, është thënë në reagimin e Institutit të Historisë.

Instituti i Historisë ka theksuar se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të tjerët e kanë vënë jetën e tyre në shërbim të mbrojtjes së identitetit dhe krenarisë kombëtare. “Personalitetet e UÇK-së që sot janë të ulur në bankën e të akuzuarave: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi etj., me bashkëlufëtaret e tyre vunë jetën në shërbim të mbrojtjes së identitetit dhe krenarisë kombëtare, që me guximin dhe vizionin e tyre u bënë kreatorë të ideve dhe veprimeve për themelimin dhe shtrirjen e luftës çlirimtare. Lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e tyre është një kurorëzim shekullor i përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri në trojet e veta, duke u dhënë fund edhe maltretimeve, dhunimeve, burgosjeve, vrasjeve

dhe gjenocidit të forcave pushtuese serbe mbi popullin shqiptar në Kosovë”, është thënë në këtë reagim, duke shtuar se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përfundimisht kishte hapur mundësinë e zgjidhjes së statusit politik e juridik të Kosovës. “Në këtë drejtim, çlirimtarët që sot po gjykohen në Hagë, kontribuuan përtej çdo pritjeje në rrethanat më të vështira të kohës, forcuan besimin dhe unitetin, duke vitalizuar dhe rritur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ngritën në këmbë një armatë çlirimtarësh, duke qenë kështu për ne, shenja e shenjtë e kujtesës sonë historike. Ata i dhanë popullit shqiptar besimin se mund të bëhet luftë çlirimtare kur ke zemër, kur ke të drejtë, kur je i gatshëm të sakrifikosh, kur je në gjendje ta dëshmosh të drejtën tënde dhe ta nxjerrësh pa maskë pushtuesin e huaj, ndërsa botës i dha mesazhin se shqiptarët nuk mund të qëndronin edhe më tej të shtypur e të maltretuar, në mbyllje të shekullit XX”, është thënë në reagimin e Institutit të Historisë. Më tutje, ky institut ka theksuar se lidhshipi i UÇK-së kishte bindur botën për drejtësinë e luftës së tyre dhe patën ndërjegjësuar faktorin ushtarak ndërkombëtar për të mbështetur këtë të drejtë deri në çlirimin e vendit. “Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e mbështetur në mendjet e mëdha ideore të kohës”, është thënë në

këtë reagim, duke shtuar se lufta çlirimtare ishte trajtuar pozitivisht nga bota demokratike. “UÇK-ja dhe lufta e saj u trajtuan pozitivisht në kancelaritë diplomatike të Evropës Perëndimore dhe të ShBA-së, përpjekjet, roli dhe forca e saj u vlerësuan edhe në terren, kurse lufta e saj e drejtë dhe gjenocidi ushtarak serb i kryer kundër popullit shqiptar, bëri që krah saj të rreshtohet edhe aleanca më e madhe ushtarake e kohës - NATO, krahas opinionit publik ndërkombëtar. Në këtë sfond, përpjekjet e shqiptarëve për liri gjetën mirëkuptimin dhe mbështetjen politike e ushtarake të opinionit ndërkombëtar, në veçanti të atij euroatlantik. Duke e mbrojtur të kaluarën, gjithnjë në bazë të vërtetës së argumenteve historike e juridike, ne mbrojmë të sotmen dhe të ardhmen e popullit tonë. E drejta e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nënkupton edhe mbrojtjen e legjitimitetit të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë, mbrojtjen e legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, procese këto që u karakterizuan nga një investim enorm i Perëndimit në Kosovë në aspektin ekonomik, financiar, social e moral, drejt ndërtimit të një shteti dhe një shoqërie demokratike në Ballkan, por edhe sakrificë fizike, shpirtërore e morale e shumë e shumë brezave në Kosovë”, është thënë në reagimin e Institutit të Historisë.



Obiliqi do të bëhet me shesh

OBILIQ, 16 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, bashkë me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Tahiri, si dhe familjarë, kanë vënë gurthemelin për ndërtimin e sheshit "Adem Preniqi", i cili do të realizohet në qytetin e Obiliqit. Me këtë rast, Gashi ka thënë se realizimi i këtij projekti do të bëhet për 9 muaj, ndërsa ka shtuar se vlera e këtij projekti është afër 1 milion euro. "Është projekt që do të investohet në një hapësirë prej 1 hektar e 14 ari. Vlera totale e projektit është 989 mijë euro.

Realizimi i projektit do të jetë për 9 muaj. Shpresojmë që të jetë kështu, nëse nuk ka ndonjë problem gjatë ekzekutimit të punimeve për shkak të pandemisë", ka thënë Gashi.

Ndërsa zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë ky shesh do ta mbajë emrin e një veprimtari dhe një qytetari të ndershëm, punëtor dhe atdhedashës i kësaj komune. "Ky shesh do ta mbajë emrin e një veprimtari dhe një qytetari të ndershëm, punëtor dhe atdhedashës i kësaj komune. Ky qytet është duke e bërë një transformim unik jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë", ka thënë Tahiri.



Ndërtohen trotuare në Pollatë të Podujevës



PODUJEVË, 16 NËNTOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, ka

vizituar fshatin Pollatë, ku janë duke u kryer punimet për ndërtimin e trotuarit.

Gjatë inspektimit të punimeve nënkryetari Rudari ka thënë se ndërtimi i trotuarit në këtë

segment lehtëson qarkullimin e këmbësorëve dhe ndikon në rritjen e sigurisë për banorët e këtij fshati, në veçanti për fëmijët që ndjekin mësimet në shkollën e fshatit.

Asfaltohen tri rrugë në kryeqytet

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se janë asfaltuar disa rrugë në kryeqytet. Kjo komunë ka bërë me dije se në ditët në vijim do të rregullohen edhe trotuaret e këtyre rrugëve. "Kanë përfunduar asfaltimet në rrugët 'Pashko Vasa', 'Mujo Ulqinaku' dhe 'Lorenc Antoni'.

Punimet po vazhdojnë dhe, pas përfundimit të rikonstruimit të tërësishëm të rrugës, qarkullimi do të jetë më i sigurt për të gjithë pjesëtarët në komunikacion. Në ditët në vijim do të përfundohen edhe trotuaret dhe do të jenë të gatshme për t'u shfrytëzuar", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Nënshkruhet marrëveshja për sterilizimin dhe vaksinimin e qenve endacakë në Junik

JUNIK, 16 NËNTOR (ER) - Komuna e Junikut ka bërë me dije se është nënshkruar një marrëveshje për fillimin e zbatimit të projektit "Sterilizimi dhe vaksinimi i qenve endacakë". Për realizimin e këtij projekti Komuna e Junikut do të jetë partnere me LMT-Junik dhe organizatat për mbrojtjen e kafshëve. "Projekti do t'i identifikojë mundësitë dhe t'i zbatojë aktivitetet me synim të realizimit të objektivave të përbashkëta për ta arritur qëllimin për zgjedhjen e problematikës dhe shqetësimin qytetar për trajtimin e qenve endacakë. Komuna e Junikut po vazhdon angazhimin për thellimin e bashkëpunimit me bashkëpunëtorët dhe donatorët. Projekti është mbështetur dhe financiar nga LMT-Junik, gjegjësisht KFOR-i italian", ka njoftuar Komuna e Junikut.



Naftëtarët kërkojnë shfuqizimin e udhëzimeve të MTI-së, thonë se u shkaktuan dëme milionëshe

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se udhëzimet e MTI-së të cilat janë marrë në kohën e pandemisë, sektorit të naftës i kanë shkaktuar dëme milionëshe. “Jemi të shqetësuar për zhvillimet që lidhen me vendimet e ndryshme në raport me kompanitë e sektorit privat, kohën e fundit me një vendimmarrje pa asnjë konsultë që po ndikon në sektorin e naftës”, ka thënë Rukiqi



Më tutje, ai ka thënë se pastrimi i rezervarëve duhet të bëhet përmes normave ndërkombëtare dhe se këto udhëzime janë nënshkruar pa konsultë me shoqatën. “Udhëzimi për pastrimin e rezervuarve kemi kërkuar të bëhet sipas normave ndërkombëtare. Ka qenë dhjetë euro, tash është bërë 26 euro”, ka deklaruar Rukiqi.

Ndërsa kryetari i Shoqatës së Naftarëve, Fadil Berjani, ka kërkuar që udhëzimet e MTI-së të shfuqizohen. “Neve na kanë detyruar të dalim në protestë, me udhëzimet e fundit që kanë nënshkruar e që janë bërë pa pëlqimin tonë. Pastrimi i rezervarëve për çdo tre vjet askund në botë nuk bëhet. Kërkojmë që këto udhëzime të

shfuqizohen”, është shprehur Berjani.

Ndërsa Tahir Zogaj, drejtor i “Shell Kosova”, ka shprehur pakënaqësitë lidhur me udhëzimet e fundit nga MTI-ja. “MTI-ja e ka bartur këtë te disa kompani private që nuk kanë as mjete dhe e bëjnë pis kur e bëjnë kalibrimin”, është shprehur Zogaj.

**EPOKA
ERE**

A.MAVRAJ

PRISHTINE, 16 NËNTOR- Kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, së bashku me kryetarin e Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, kanë mbajtur konferencë për media lidhur me udhëzimet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) që po konsiderohen të padrejta dhe me humbje milionëshe edhe nga Shoqata e Naftëtarëve. Lidhur me këtë, kreu i OEK-ut ka thënë se udhëzimet që kanë ardhur në kohë të pandemisë kanë krijuar efekt financiar milionësh në dëm të bizneseve. “Jemi të shqetësuar për zhvillimet që lidhen me vendimet e ndryshme në raport

me kompanitë e sektorit privat, kohën e fundit me një vendimmarrje pa asnjë konsultë që po ndikon në sektorin e naftës. Në kohë pandemie janë tri masa të ndryshme që kanë efekte milionëshe në sektorin e naftës. Krijohet përshtypje që këto kompani kanë mjete pa kufij dhe me këto mendohet se duhet përmbushur kërkesa e ministrive të ndryshme. Këto vendime e rrisin koston e operimit të tyre që në pandemi janë dëmtuar shumë. Në kohë të pandemisë, kur ne kemi bërë përpjekje që të mos ketë ndëshkime, gjopa apo kërkesa për ndonjë taksë shtesë, vijne tri udhëzime brenda një viti që krijojnë efekt financiar milionësh në dëme të këtyre bizneseve”, ka deklaruar Rukiqi.

Zyra ligjore e Kuvendit s'i jep mandat komisionit t'i pezullojë lejet për hidrocentralet

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Zyra ligjore e Kuvendit të Kosovës ka vlerësuar se komisioni hetimor për hidrocentralet nuk ka mandat ta pezullojë lejen e lëshuar nga institucionet përkatëse për operimin e hidrocentraleve. Në mbledhjen e këtij komisioni të mbajtur të hënën, deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se zyra ligjore me interpretimin e saj ka kufizuar fushëveprimin e komisionit në fjalë. “Sipas përfundimeve të zyrës ligjore ne s'kemi mandat për ta bërë një pezullim të tillë. Fushëveprimi ynë na kufizon”, ka thënë ajo.

Ndërsa Haxhi Avdyli, anëtar i këtij komisioni, ka shprehur shqetësimin e tij se si në kohën kur po hetohen lejet për hidrocentralet, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit i ka lëshuar leje një kompanie për të operuar. “Shfaq indinjatën time

që në kohën kur komisioni ynë po gjënen të gjitha keqpërdorimet, ndodhi që ZRrE-ja e Ministria e Ekonomisë jep leje për një operator. Është një goditje dhe kjo tregon se ne mund të bëjmë çfarë të duam. Mendoj se mendimi i zotëri Abrashit, që të ketë kërkesë për pezullim të punës, ka qenë i drejtë. Ne duhet ta shtojmë vëllimin e punës dhe t'i thërrasim ata që kanë qenë përgjegjës në të kaluarën, edhe ZRrE-në edhe ‘Kelkos’-in për dhënien e lejes mjedisore për një operator që nuk i ka përmbushur kushtet”, ka thënë Avdyli.

Në anën tjetër, deputetja e LDK-së, Besa Gaxherri, anëtare e komisionit hetimor për hidrocentralet, ka thënë se ata e kanë të pamundur të marrin vendim për pezullimin e lejeve për hidrocentralet. Ajo ka kërkuar raportim të ministrit të



Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi dhe bordit të ZRrE-së, pas vendimit për dhënien e lejeve për “Kelkos”. “Është e pamundur që ne si komision të marrim vendim për pezullim të lejeve. Situata është e keqe. Tre muaj s'do të na mjaftojnë. Ne jemi vonuar

në hapa. Ende s'kemi angazhuar ekspertë. Ne ende s'e kemi kontratën e nënshkruar të ‘Kelkos’-it me qeverinë. Vendimet e ZRrE-së dhe qeverisë janë shqetësuese. Ata duhet të argumentojnë. Ne duhet të dimë si ‘Kelkos’-i ka marrë leje për dy

hidrocentralet. Ne kemi parë që terreni është shqetësues për ambientin. Urgjent ministri të vijë këtu, po ashtu edhe kryesuesi i bordit të ZRrE-së”, ka thënë Gaxherri.

Më tutje, deputeti nga Lëvizja Vetëvendosje, Artan Abrashi, anëtar i këtij komisioni, ka thënë se me interpretimin e zyrës ligjore është vënë në pikëpyetje autoriteti i deputetëve. “Ndodhemi në një situatë goditëse. Është vënë në pikëpyetje autoriteti i deputetëve të Kuvendit. Propozimi im lidhur me pezullimin kishte të bënte me pengimin e një situatë në të cilën jemi edhe ne. Është për keqardhje mosgatishmëria e institucioneve që t'i sjellin dokumentet që na duhen edhe pse janë të detyruar”, është shprehur ai.

Krejt në fund, deputeti Shpejtim Bulliqi ka kërkuar që Kuvendi ta shkarkojë bordin e ZRrE-së.

Protestojnë punëtorët e Telekomit pas bllokimit të xhirollogarive, kërkojnë përgjegjësi nga qeveria



PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Sindikata e Punëtorëve e Telekomit ka protestuar para objektit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për shkak të gjendjes së krijuar në këtë ndërmarrje. Punëtorët e Telekomit ende nuk i kanë

marrë pagat e muajit tetor, derisa kanë thënë se tashmë është duke u rrezikuar seriozisht edhe funksionimi i ndërmarrjes. Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lamih Balaj, para protestuesve, ka fajësuar Qeverinë dhe Kuvendin

për gjendjen në të cilën gjendet kjo ndërmarrje. “Kjo protestë është me fajin e atyre që janë në qeveri dhe të atyre deputetëve që janë në Kuvend. Jemi një nga ndërmarrjet që na janë bllokuar xhirollogaritë. Çdo moment rrezikohen një milion

konsumatorë. Qeveria dhe Kuvendi ta marrin në përgjegjësi këtë gjendje. Ne nuk do t'i ndalim protestat. Kërkesat tona janë zhblllokimi i llogarive bankare dhe dhënia e pagave punëtorëve”, është shprehur Balaj.



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

LUFTA E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, PROPAGANDA SERBE DHE AKTAKUZAT KUNDËR UÇK-së

Kushdo që ka përcjellë zhvillimet e procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave dhe luftërave që ndodhën gjatë këtij procesi e di fare mirë se gjatë luftërave dhe pas përfundimit të tyre u vranë civilë. Rreth këtij fakti ka një konsensus të përgjithshëm. Divergjencat fillojnë kur kërkohet të dihet se **kush i kreu vrasjet e tyre**. Pikërisht në funksion të fshehjes së përgjegjësisë së vet për vrasjen e civilëve në Kosovë, gjatë gjithë luftës dhe pas përfundimit të saj, Serbia zbatoi strategjinë e njollosjes së luftës së UÇK-së duke u përpjekur ta bënte fajtorë për krimet që i kishin kryer forcat serbe, dhe në këtë mënyrë të fshihte gjurmët e gjenocidit në Kosovë.

Fillimisht po përmend faktin se në funksion të strategjisë së prezantimit të shtrembëruar të aspiratave çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës, Sigurimi Shtetëror i Serbisë përgatiti

materialin e titulluar "Bela knjiga: Terorizam Albanskog separatizma na Kosovo i Metohiji" ("Libri i bardhë: Terrorizmi i separatistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Dukagjin"), i publikuar në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, në Beograd, shtator 1998.

Ky libër u botua i përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe në gjuhën frënge, dhe kjo ministri ua shpërndau falas institucioneve me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare, institucioneve shtetërore të shteteve anëtare të OKB-së, mediave ndërkombëtare, bibliotekave universitare dhe personaliteteve me peshë në fusha të ndryshme intelektuale.

Variante të plotësuara të këtij "Libri të bardhë" u ribotua nga regjimi i Milosheviqit në janar të vitit 1999 me titull: "Zlo in albanskih terorista" (Krimet e terroristëve shqiptar) dhe në mars të vitit 2000 u botua varianti

anglisht i titulluar "Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija: documents and evidence 1 January 1998 - 10 June 1999" (Aktet terroriste të grupeve terroriste shqiptare në Kosovë dhe Dukagjin).

Pas përmbysjes së Sllobodan Millosheviqit nga pushteti, qeveria e re e Beogradit vazhdoi me të njëjtën propagandë. Në nëntor të vitit 2001, u botua dhe u shpërndau varianti i ri i propagandës së vjetër: "rtve albanskog terorizma na Kosovo i Metohiji (Ubijena, oteta i nestala lica, januar 1998 - novembar 2001)" [Viktimat e terrorizmit shqiptar në Kosovë dhe Dukagjin (personat e vranë, të rrëmbyer dhe të zhdukur, janar 1998-nëntor 2001)].

Sipas pohimeve publike të funksionarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, Vladimir Bozhoviq, "me qëllim të përgatitjes dhe të sigurimit të

dëshmime materiale kundër UÇK-së, ai ishte takuar disa herë me Prokuroren e Përgjithshme të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi, Carla Del Ponten dhe me Clint Williamsonin, i cili ishte shef i Departamentit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut të UNMIK-ut në periudhën 2001-2002, (Gjatë periudhës 1994-2001 Clint Williamson ka punuar si prokuror në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi) dhe u kishte dhënë këtë libër dhe dosjet me mbi 27 mijë faqe". [Gazeta Politika, Biljana Bakovi, Za trgovinu organima Beograd saznao pre devet godina, (Për tregtinë me organe Beogradi ka qenë në dijeni para nëntë vitesh), 02.01.2011], dhe Biljana Radomiroviq, Obmane Del Ponteove (Mashtrimet e Del Pontes).

Nën ndikimin e këtyre dosjeve të sajuara nga Shërbimi Sekret i

Jugosllavisë, Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ngriti aktakuza kundër Fatmir Limajt, Haradin Balajt dhe Isak Musliu. (Tribunal Pénal International pour l'ex-Yougoslavie, Affaire N° IT -03-66-1).

Në aktakuzën e parë të datës 24 janar 2003 (Tribunal Pénal International pour l'ex-Yougoslavie, Affaire N° IT -03-66-1, Acte d'accusation, 24 janvier 2003) dhe në aktakuzën e ndryshuar të datës 7 mars 2003 (Tribunal Pénal International pour l'ex-Yougoslavie, Affaire N° IT -03-66-1, Acte d'accusation modifié, 7 mars 2003), kemi zbatimin e teknikës Copy/Past të "dëshmimeve" të dorëzuara nga njerëzit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Jugosllavisë dhe të sajuara nga Shërbimi Sekret i Jugosllavisë.

Mirëpo, në shtator të vitit 2003,

regjimit të "ri" në Beograd botoi një variant të ri të "librit të bardhë", të ndryshuar në përputhje me ndryshimin e rrethanave në skenën politike ndërkombëtare. Në një konferencë për shtyp të mbajtur në Kuvendin e Serbisë, kryeministri i Serbisë, Zoran Zhivković, zëvendëskryeministri dhe shefi i të ashtuquajturës "Qendra Koordinuese për Serbinë Jugore dhe Kosovë dhe Dukagjin...", Nebojša Čović, dhe shefi i Shërbimit Sekret Serb, Misha Milliqeviq prezantuan librin e titulluar "Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovo i Metohiji" (Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Dukagjin).

Në këtë konferencë për gazetarët kryeministri serb deklaroi se "qëllimi i publikimit të këtij libri është t'u ndihmohet atyre që duhet të veprojnë kundër kriminalitetit të organizuar, para se gjithash UNMIK-ut dhe KFOR-it (...). Është përfolur se gjoja nuk ka prova të mjaftueshme për të ndërmarrë veprime të tilla, se u mungojnë faktet konkrete e kështu me radhë. Libri "Terrorizmi Shqiptar dhe Kriminaliteti i Organizuar në Kosovë dhe Dukagjin" ofron mjaft sqarime dhe fakte për krimet e kryera në Kosovë dhe Dukagjin, të cilat mund të jenë mjaft interesante edhe për punën e Gjykatës në Hagë". (<http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>, më 7 dhjetor 2003)

Me qëllim që të ndikohet te institucionet ndërkombëtare të drejtësisë dhe të sigurohet mbështetja ndërkombëtare në luftë kundër "terrorizmit shqiptar", në këtë material të ri propagandues serb, Ushtria Çlirimtare e Kosovës përshkruhet si "organizatë terroriste që përdorin dhunën kundër popullsisë civile serbe, shqiptare dhe pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike që jetojnë në krahinë si dhe kundër policisë e Ushtrisë Jugosllave (...) Krahas aksioneve terroriste në nivelin lokal, ata vendosin lidhje me grupet terroriste islamike që veprojnë në planin global dhe financohen në mënyrë të ngjashme si grupet e tjera terroriste, duke siguruar mjetet financiare me dhunë ose nga trafiket me drogë." Sipas po të njëjtës propagandë "Përveç tregtisë me lëndë narkotike, mafia shqiptare vuri nën kontrollin e saj edhe prostitucionin ndërkombëtar, tregtinë ilegale të armëve, të cigareve dhe të mallrave të tjera me akcizë, të automobilave të vjedhur, trafikimin me njerëz dhe shitjen e organeve njerëzore (...)" (Qeveria e Serbisë, "Libri i bardhë-Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar.", botimi 2003, f.23).

Efekti i kësaj propagande te Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ishte i menjëhershëm dhe në dy drejtime:

Carla Del Ponte urdhëroi zhvillimin e hetimeve lidhur me

dyshimet për "trafikim të organeve njerëzore nga ana e UÇK-së" dhe kërkoi nga "UNMIK-u, nga autoritetet lokale të Kosovës dhe të Shqipërisë të shoqërohen nga shërbimet e policisë serbe" për të ndriçuar këto pretendime. Kërkesa e Carla Del Pontes që UNMIK-u, autoritetet lokale të Kosovës dhe të Shqipërisë të mbështeten në shërbimet policore serbe është kërkesë për të arsyetuar, tërthorazi, mbështetjen e vet te këto burime;

Më 6 nëntor 2003 ajo ndryshoi aktakuzën për herë të dytë dhe e përshtati me variantin e ri të propagandës së Qeverisë së Serbisë.

Për t'u përshtatur me librin propagandistik serb "Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Dukagjin", ku rreth 100 herë UÇK-ja cilësohet si "organizatë kriminale", në variantin e tretë të aktakuzës (Tribunal Pénal International pour l'ex-Yougoslavie, Affaire N° IT -03-66-1, Deuxième acte d'accusation modifié, 6 novembre 2003) Carla Del Pontes, me dhjetëra herë e cilëson UÇK-ja si "Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale" që gjoja ka kryer sulme të përgjithshme dhe sistematike të drejtuara kundër popullsisë civile serbe dhe shqiptarëve që dyshoheshin si bashkëpunëtorë" dhe kinse "kundër tyre ka zbatuar tortura, trajtime mizore, vrasje..." (Varianti i tretë i aktakuzës së lartpërmendur i datës 6 nëntor 2003, pikat 6-13 dhe 19-27).

Në të njëjtën frymë si ajo që mbizotëronte në aktakuzën kundër Fatmir Limajt dhe bashkëlufetarëve të tij dhe e mbështetur në sajatat e materiale të dorëzuara nga përfaqësuesit e Serbisë, më 4 mars 2005, Carla

Del Ponte ngriti aktakuzë kundër Ramush Haradinajt, Lahi Brahimajt dhe Idriz Balajt (Tribunal Pénal International pour l'ex-Yougoslavie, Affaire N° IT-04-84bis-PT, 4 mars 2005).

Që në variantin e parë të kësaj aktakuzë dhe në katër variantet e modifikuara të aktakuzës, Carla Del Ponte zbaton teknikën e njëjtë Copy/Past të "dëshmive" të sajuara nga Shërbimi Sekret Serb dhe të cilësimeve të UÇK-së si "Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale".

Të dy proceset gjyqësore kundër komandantëve dhe luftëtarëve të lartpërmendur të UÇK-së përfunduan me pafajësinë e plotë të të pandehurve. Megjithatë, proceset gjyqësore të motivuara politikisht dhe të mbështetura në "provat" serbe shkaktuan vuajtje të mëdha individuale dhe familjare për njerëzit që padrejtësisht kaluan vite të tëra në burgje dhe procese gjyqësore.

Ndërkaq, pas hetimeve të hollësishtme disaveçare dhe në pamundësi të gjenin qoftë edhe një provë të vetme që do të mbështeste shpifjet për gjoja "trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja", Carla Del Ponte, urdhëroi ndërprerjen e hetimeve. Pesë vjet më vonë, Carla Del Ponte i kthehet kësaj çështjeje dhe në librin autobiografik ajo deklaron: "Këto lloj historish të burgosurish, të vrarë nga trafikantët e organeve, rikthehen mjaft shpesh në zonat e konflikteve, por shumë rrallë ka prova konkrete për t'i argumentuar këto tregime, të cilat përfundojnë si legjenda të thjeshta". [Carla Del Pontes, botimi në gjuhën frënge, "La traque, les criminels de guerre et moi" (Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës"), f.470]. (VIJON)



Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë: Të bëhemi bashkë dhe ta miratojmë rezolutën për gjenocidin serb

TIRANË, 16 NËNTOR - Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, Ralf Gjoni, u ka bërë thirrje socialistëve, veçanërisht kryetarit të grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, që ta miratojnë së bashku një rezolutë për t'i dënua krimet e serbëve ndaj shqiptarëve. Ai ka thënë se ka ardhur koha që Tirana dhe Prishtina të flasin njëzëri, që të mos ketë kufi dhe për ta mbrojtur imazhin e Kosovës. "Nuk ka mundësi që për shkak se kemi komplekse nga disa burracakë në BE, që ne ta përdhosim luftën e Kosovës, që ka qenë luftë e shenjtë për t'i mbrojtur viktimat e Milloveshiqit, ndaj gjenocidit serb kundër shqiptarëve në Kosovë. Ka ardhur koha që Tirana dhe Prishtina të flasin njëzëri, ka ardhur koha të mos ketë më kufi midis Shqipërisë dhe Kosovës. Duhet të flasim njëzëri për ta mbrojtur imazhin e Kosovës", ka thënë Gjoni.

Deputeti shqiptar ka thënë se duhet të lihen akuzat e


ndërsjella dhe të bëhemi bashkë një herë të vetme për kombin tonë pasi, siç ka thënë ai, kombi është mbi gjithçka dhe sidomos përmbi interesat meskine të partiçkave. "U bëj thirrje socialistëve, zotit Balla në veçanti, që duhet të ulemi bashkërisht ta diskutojmë në interes kombëtar ku ta dënojmë gjenocidin serb ndaj shqiptarëve. S'duhet të lejojmë që Vuçiqi ta fitojë luftën e informacionit duke e kthyer pllakën. Ajo gjykatë në Hagë nuk u shërben interesave shqiptare. Është antishqiptare. Serbia është ulur këmbëkryq në Tiranë, t'i bashkojmë forcat, t'i lëmë akuzat e ndërsjella dhe të bëhemi bashkë një herë të vetme për kombin tonë. Kombi është mbi gjithçka dhe sidomos përmbi interesat meskine të partiçkave. Zoti Balla, eja ulemi kalojmë një rezolutë për t'i dënua krimet e serbëve ndaj shqiptarëve", ka thënë Gjoni, i cili fjalën e tij në Kuvend e ka përqendruar te gjyqi ndaj ish-drejtuësve të UÇK-së në Hagë.



Албански
тероризам и
организовани
криминал на
Косову и
Метохији



'MASHTRIMI I MADH', A ISHTE SHTABI I PËRGJITHSHËM NJË 'ORGANIZATË E STRUKTURUAR KRIMINALE' DHE KËRCËNIMI NDAJ SERBISË NËSE PUBLIKOHEJ LISTA E KRIMEVE KUNDËR SHQIPTARËVE NË KOSOVË (2)



Nga Bedri ISLAMI

Më 9 nëntor 2020, dy nga drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Jakup Krasniqi, zëdhënasi politik i saj që nga qershori 1998 dhe drejtori politik, Hashim Thaçi, ishin para Gjykatës Speciale për ta dëgjuar aktakuzën ndaj tyre, çka është e njohur tashmë, megjithëse jo në të gjitha detajet, për shkak të disa censurimeve. Një ndër akuzat themelore mbi veprimet dhe qëndrimet e të akuzuarve të tanishëm është përfshirë në togfjalëshin "grup i strukturuar kriminal", ose edhe më tej "ndërmarrje e strukturuar kriminale", që shkon edhe përtej tyre, duke synuar të paraqesë në këtë trajtim të gjithë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ai që mendon se kjo gjykatë në deklarimet e saj ka të bëjë vetëm me disa njerëz në zinxhirin e lartë komandues, ai është krejt i gabuar. Hapësira e aktakuzës është shumë më e gjerë, çka e detyroi senatorin Tom Engel të kërkojë nga qeveria e diçka të shohë nga afër dhe konkretisht veprimtarinë e kësaj gjykate. Të duket se kjo strukturë, e cila vepron në kornizën e Kushtetutës së Kosovës, jo vetëm se nuk e njeh shtetin që e ka formësuar dhe i ka hapur dritën e gjelbër, por synon të rrënojë edhe atë çka është njohur juridikisht nga instanca të larta gjyqesore. Pretendimi se krimet e kryera nga UÇK-ja në periudhën për të cilën ka hapësirë Gjykata Speciale në tërë kompleksitetin e saj nuk janë raste të izoluara e sporadike, apo krime të individëve të caktuar, por janë krime të organizatës madje të mirëmenduara, të planifikuara e sistematike është prezent në gjithë aktakuzën, herë në mënyrë të drejtpërdrejtë e herë

tërthorazi. Kjo vërehet qartë e thuhet drejtpërdrejt në pikën 39 të aktakuzës, sipas së cilës, të akuzuarit (citoj): "Si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kanë lëshuar direktiva, udhëzime dhe urdhra në lidhje me kundërshtarët. Fokusi te kundërshtarët ngjashëm reflektohej në disa rregulla dhe rregullore të brendshme, në trajnime, dokumente politike dhe broshura informative të hartuara dhe lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nivelet e tjera të komandës së UÇK-së/ Qeverisë së Përkohshme të Kosovës".

Sa është e vërtetë kjo:

Në komunikatën nr. 19 të Shtabit Qendror të UÇK-së, 25 prill 1996 (deri në maj 1998 emërtohej Shtabi Qendror dhe më pas Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së), është shënuar me forcë se "Lufta e armatosur e popullit shqiptar nuk ka karakter 'terrorist'", nuk ka karakter të luftës ndëretnike e as karakter fetar. Ajo është luftë për çlirimin e Kosovës". Këtij përcaktimi i është përmbajtur edhe Shtabi i Përgjithshëm. Në periudhën për të cilën bëhet fjalë, sidomos pas marsit të vitit 1998, rrethimit, luftës dhe vrasjes së Familjes Jashari, mes tyre edhe të komandantit të përgjithshëm, Adem Jashari, së bashku me 54 pjesëtarë të familjes dhe të afërm të tij, hovi rritës në UÇK ishte i paparashikuar nga strukturat e shtetit serb, por i pritshëm nga strukturat drejtuese të luftës. Por rritja duke qenë e shpejtë dhe në një kohë të shkurtër, pasi nga rreth 370 forca të aktivizuara vazhdimisht, sa ishin në radhët e UÇK-së në marsin e vitit 1998, do të kalohej në muajin qershor në mbi 30 mijë vetë, pra rreth 100 herë më shumë dhe, edhe në një shtet solid, të mirëorganizuar, të fuqishëm dhe në liri, do të ishte e vështirë riorganizimi pa probleme dhe normalisht i tyre. Shumë prej tyre vinin nga strukturat e Lëvizjes Popullore të Kosovës, të cilat ishin shndërruar pas marsit në njësi të UÇK-së, por

edhe nga një masë e madhe njerëzore, përgjithësisht e përgatitur për luftë, por edhe hovet që shpërthenin nga vuajtjet e shkaktuara. Megjithatë, në të gjitha anët Shtabi i Përgjithshëm, e më shumë se ata shtabet e zonave, të cilat u rritën vazhdimisht dhe u fuqizuan, kishin jo vetëm përgjegjësinë, por edhe bënë çka ishte e mundur që të mos kishte eksese, krime dhe ndëshkime etnike, politike; ndërsa nuk është vënë asnjëherë në dyshim se nuk do të kishte ndasi fetare, një fenomen që nuk ka ekzistuar as në çastet më të vështira të luftës në Kosovë. Cilësimi nga prokurori i specializuar në aktakuzë të një grupimi të përndjekur "katolikë" është një qorrsokak ku e futi veten dhe ku duket se përkthimi i materialeve të dërguara nga prokuroria serbe është përkthyer pa bërë redaktimet e nevojshme. Aktakuza si ka vërejtur analisti Jusuf Thaçi, ashtu si është hartuar dhe paraqitur, e si u përshfaq edhe ditën e djeshme, nuk është ndaj emrave të përveçëm e rasteve individuale, por është ndaj gjithë zinxhirit komandues të UÇK-së dhe vetë UÇK-së si organizatë. Kjo theksohet në pikën 35 të aktakuzës, në të cilën përveç emrave të përveçëm, për krimet e pretenduara akuzohet si strukturë pothuajse gjithë UÇK-ja, përfshirë Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, komandantët e zonave operative, zëvendëskomandantët e zonave operative, eprorët tjerë të komandave të zonave, komandantët e brigadave, komandantët e njëjësive, policinë ushtarake, eprorët tjerë të UÇK-së dhe ushtarët e UÇK-së. Përveç gjithë zinxhirit strukturor të UÇK-së, aty po akuzohet edhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës (pjesa e UÇK-së) si tërësi me të gjithë strukturat e saj. Argument tjetër se nuk po akuzohen individët, por struktura dhe organizata janë pikat 53, 54, 55 dhe 172 të aktakuzës, por edhe gjithë aktakuza në përgjithësi, sepse

katër anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm në përgjithësi akuzohen për përgjegjësi komanduese (planifikim, lejim, mos-ndalim, urdhërim, etj. të krimeve të pretenduara) e shumë pak akuzohen për përfshirje personale të drejtpërdrejtë në realizimin e krimeve të pretenduara. Pra, qëllimi është i qartë, kriminalizimi i gjithë kopolës dhe gjithë strukturave të UÇK-së, prej Shtabit të Përgjithshëm e deri te ushtarët e thjeshtë. Mundësia më e madhe për të pasur revansh politik dhe për të qenë pjesë e kriminimit ishte menjëherë pas masakrave në Prekaz, Çirez, etj., ku u vranë edhe fëmijë, gra, pleq e plaka, disa nga të cilët u takonin UÇK-së, e të tjerë ishin familje të zakonshme. Asaj kohe gjithçka ishte shpërthyes dhe shumë vetë do të mendonin se kishte ardhur koha e hakmarrjes. Ndoshta prokurori i specializuar nuk e di, por në këtë periudhë nuk ka asnjë serb të humbur. Periudha e dytë e mundshme për hakmarrje, kur plagët ishin të freskëta ishte pas-qershori i vitit 1999 dhe përsëri ndodh e njëjta gjë-krime nuk ka, serbë të zhdukur nuk ka. Në Kosovë njihet ajo që ndodhi në një çajtoze në Pejë ku u vranë disa të rinj serbë. Ishte mesi i luftës. U akuzua UÇK-ja dhe shteti serb këtë vrasje të të rinjve e përhap gjithë ku mundi. Më vonë u provua se ishte një vrasje e organizuar nga vetë pushtuesit serbë për të nxitur krimin dhe justifikuar aktet e barbarisë. Nuk besoj se ka njerëz që mendojnë se në Kosovë nuk ka njerëz të frustruar, të cilët, kur kanë parë varret e të afërmeve të tyre nuk do të kishin dashur, sidomos në çastin e parë, të hakmerreshin dhëmb për dhëmb dhe sy për sy. Do të ketë pasur, si kudo në botë. Kjo nuk ndodhi. Ka një shkak. Është vetë vlera reale e besimit që ke, pasi lufton për një kauzë më të madhe se ajo e familjes tënde. Prej gati 24 viteve jam mik i afërt i familjes së Adem Jasharit, kam publikuar letrat e fundit të tij dërguar Lëvizjes Popullore të

Kosovës, kam ndjekur biseda të Ademit dhe të Hamzës, dhe askund, as nga ata vetë sa ishin në jetë e as nga familjarët e tyre nuk kishte asnjëherë mlllef të verbër për hakmarrje. Dhe, shumë kush mund të mendonte se kjo familje e shumë të tjera si këto do të ishin në të gjithë të drejtën e Zotit e të robit për të pasur shpagimin e saj. Shtabi i përgjithshëm, shtabet e brigadave, drejtuesit e formacioneve, pikërisht kur mendohej se duheshin përgëzuar për përmbajtjen e mllëfit dhe të urrejtjes, janë tashmë të akuzuar. Kam menduar shpesh për rastin e mikut tim Gani Lipaj, çka e kam përmendur edhe në një rast tjetër. Kam qenë i pranishëm në shtëpinë e tij, së bashku me një mik të përbashkët, atdhetarin e njohur Avdyll Hima, kur nga Televizioni Shtetëror jepeshin pamjet e nxjerrjes nga pusi të familjarëve të tij, që më parë ishin vranë nga paraushtarakët serbë. Shihnim se si nxirrin nga pusi kufomat e prindërve të tij të moshuar, të vëllait, bashkëshortes, fëmijëve dhe mendoja se njeriu në një moment të tillë mund të luajë mendsh. Më pas kam menduar se çfarë mund të kishte ndodhur në ato çaste Ganiu do të kishte qenë në Kosovë, në fshatin e tij, të kishte mësuar se njëri nga fqinjët e tij të dikurshëm serbë kishte prirë në këtë masakër dhe ai, Ganiu t'i kishte hyrë në dru. Ganiu tani do të ishte në Hagë, fqinji i tij që u bë paraushtarak do të merrte pension në Serbi ose do të ishte dëshmitar i mbrojtur në një vend të fshehtë. Por isha i bindur se ai nuk e ftonte hakmarrjen të ishte pjesë e jetës së tij.

Çfarë ndodhi mes UÇK-së dhe LDK-së?

Shpesh herë në aktakuzën e prokurorit të specializuar cilësohen se mes kundërshtarëve të keqtrajtuar, të torturuar, të burgosur etj., ishin edhe aktivistë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Sa është e vërtetë kjo?

Është e ditur se mes UÇK-së dhe LDK-së ka patur qëndrime të ndryshme, herë pas here të kundërta, përplasje dhe tensione, por kurrë përleshje si forca politike. Ndoshta prokurori i specializuar duhet të dijë se në radhët e UÇK-së ishte më shumë se gjysma e kryesisë së lartë të LDK-së, që nga nënkryetari, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Berat Luzha, Ali Laçej, Ramë Buja, Basri Musmurati, Gani Sylja, të gjithë ish të burgosur politikë. Nuk ka pasur asnjë njësi që është ndarë, këndej ata të UÇK-së, andej ata të LDK-së. Megjithatë Lëvizja Popullore e Kosovës kishte themeluar, drejtuar politikisht dhe mbështetur organizativisht Ushtrinë Çlirimtare, pra ishte themeluese e saj, ajo, pas propozimit të Fehmi Lladrovci dhe shpallur nga Jakup Krasniqi në deklaratën e parë Politike si zëdhënës politik, ishte për ndërprerjen e të gjitha veprimtarive partiake. Zoti Rugova ka qenë i informuar për veprimtarinë e UÇK-së gjatë një takimi të veçantë të drejtuesve të lartë të Lëvizjes Popullore të Kosovës që kishin me të, ku ishte edhe Fehmi Agani. Vetë profesor Agani gjatë Konferencës së Rambujesë, mbështeti të gjitha propozimet e vyera të delegacionit-pjesë e UÇK-së, sidomos për ngushtimin e predispozitave presidenciale, duke rritur rolin e Kuvendit. Përfshirja globale nën një tekst do të jetë fshehja e fundit e vrasjeve që kanë motivacion politik, sidomos ndaj disa figurave të njohura që vinin nga LDK-ja. Askush nuk i di deri tani vrasësit e tyre, ashtu si nuk dihen vrasjet e ndodhura në dhjetëra raste, shumë herë më tepër, që kanë ndodhur me figura të njohura të luftës, pas qershorit të vitit 1999. Nuk është e saktë ajo që cilësoi këto ditë një politikan i njohur shqiptar, Berisha se "komandantët e UÇK-së kanë akuzuar njëri tjetrin për vrasje". Ka pasur vetëm një vrasje gjatë luftës brenda radhëve të saj, ajo e komandantit Abedin Rexha, ndodhur në Drenicë dhe, kur nga një deklaratë politike është akuzuar një familje e njohur, vetë shtabi operativ i zonës së Drenicës e ka kundërshtuar atë. Tentimi për të fshehur në një thes të gjitha vrasjet e pasluftës, sidomos me motiv politik, është rifshehja e tyre. Kushdo që e ka ndjellë, planifikuar dhe realizuar duhet ndëshkuar, por kjo nuk ka të bëjë me qëndrimet ndaj LDK-së. Jam krejt i bindur dhe e di fare mirë se nuk ka pasur asnjë vendim për eliminimin e zotit Rugova, edhe kur për atë, nga qeveria në mërgim, janë premtuar shuma të konsiderueshme financiare. Askush nuk ka qenë i aftë të planifikojë dhe të fitojë një luftë brenda shqiptare, pasi kujtdo do i ka dalë mjaft pushteti serb. Po ashtu, përpjekjet për t'u viktimizuar tani se UÇK-ja planifikonte eliminimin e njerëzve të politikës në Shqipëri janë aq

bajate dhe pa vlerë saqë tani, kur dëshmojnë rrejtshëm, janë aq budallaqe, sa që nuk i mban më tej. Ndaj zotit Berisha dhe njerëzve të tij nuk ka pasur asnjë plan tentimi e as nuk është diskutuar asnjëherë. Ai, pas vitit 1997, nuk ishte faktor dhe megjithatë e kishim dashur bashkëpunimin edhe me të, nuk ka qenë e mundur. Në fakt ka ndodhur e kundërta, njerëz pranë Berishës, në veriun e Shqipërisë, janë përpjekur të ndalojnë aktivitetin e UÇK-së dhe asnjëherë nuk kemi dyshuar se këto janë bërë pa dijeninë e tij. Sulejman Berisha, një i afërm i tij, ka qenë bazë e UÇK-së që nga fillimet, së bashku me Sulejman Krasniqin e djemtë e tij. Shtabi i Përgjithshëm dhe struktura e lartë drejtuese e LPK-së vetëm një herë është konkretizuar tek zoti Berisha, kur ndodhën ngjarjet e 14 shtatorit 1998, të cilat i cilësuan si tentim për grusht shteti. Nga ana tjetër, asnjëherë, as Shtabi i Përgjithshëm, as Drejtoria Politike dhe as Kryesia e Lëvizjes Popullore e Kosovës nuk kanë dalë kundër qëndrimin të Berishës për marrëveshjen e Rambujesë, e ardhur pas dorëzimit të Draftit të Dytë të Marrëveshjes, pasi ishte në përputhje me qëndrimin e UÇK-së, që nuk i njihnte kushtet e atij Drafti fatal, që u hodh poshtë. Ndërlidhje normale UÇK-ja ka pasur edhe me parti të tjera që i takonin spektrit të së djathtës në Shqipëri, si me Partinë Republikane dhe zotin Godo. Jam takuar me zotin Godo në Rambuje, gjatë ditëve të zhvillimit të Konferencës, ku ai kishte ardhur si kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë, për të koordinuar veprimet dhe mbështetur delegacionin shqiptar, kemi biseduar gjatë, mendimet e tij ishin të vlefshme dhe shumë më të avancuara në dobi të UÇK-së, se sa vetë shteti shqiptar. Vrasjet politike duhen sqaruar jo në bllok, jo përmes zinxhirit komandues, por konkretisht, që të mos mbeten enigmë. Nuk do të çuditesha, përkundrazi do më saktësohej bindja se e gjitha kjo ka ndodhur si

në rastin e vrasjes së pesë të rinjve në një çajtoreshë në Pejë, ku fillimisht u akuzua UÇK-ja e më pas vrasësit dolën serbët.

Shqipëria dhe UÇK-ja

Kjo është një temë e gjatë, për të cilën kam shkruar në disa libra të mi. Në Shqipëri ka shpërthyer një fushatë për të gjetur fajtorin, shkaqet, akuza dhe përgjigje të ashpra dhe asnjëra prej tyre nuk ka të bëjë me gjendjen dhe atë që duhej të ishte bërë. Akuzat e Karla del Pontes dhe të Dick Martyt kanë kaluar në dyert e dy qeverive. Asnjëra prej tyre nuk e ka bërë detyrën. Nëse në vitet 1998-1999, sidomos pas takimit të pjesëtarëve të Drejtorisë Politike të UÇK-së me zotin Holbruck dhe takimin e tij në Junik me pjesëtarë të UÇK-së, ndërlidhjet kanë njohur rritje dhe përparësi ka qenë mbështetja e luftës në Kosovë, por edhe e zotit Rugova, ku shqueshin drejtuesit e lartë të qeverisë, Majko e Meta, ministri i Mbrojtjes, miku ynë i çmuar Sabit Brokaj, shefi i Shërbimit Informativ Klosi, përmes të cilit janë vendosur kontakte me institucione të rëndësishme të shërbimeve inteligjente euroatlantike, periudhë në të cilën Shqipëria mirëpriti çka nuk ishte menduar, rreth 1 milion të dëbuar nga pushtimi dhe reprezaljet serbe, tani është kohë tjetër. Dekoratat janë ndarë, faji nuk mund të ndahet më tej. Në këto vite qeverisje nga dy forcat politike duheshin dorëzuar fakte dhe materiale të rëndësishme që do të demantonin aktakuzat e sotme për burgje dhe kampe në Shqipëri, për tortura dhe keqtrajttime e deri vrasje. Duheshin dorëzuar materiale, dëshmi e fakte që demantonin propagandën e shtetit serb, që, si kudo edhe në Shqipëri ka gjetur dyer të hapura, që nga njerëz të veçantë, media dhe personazhe publikë. Grindjet e tashme nuk bëjnë asgjë tjetër veçse shurdhërojnë gjetjen e të vërtetës. Shqipëria nuk duhej të pranonte të miratonte dokumentin e Dick Martyt, duhej të kishte denoncuar

në kohën e duhur maskarallëkun që fshihej aty; ajo duhej të kishte forcën e duhur që EULEX-i të lejohej të vepronte nën ose bashkërendimin me sistemin shqiptar, si një shtet i pavarur dhe i aftë të drejtojë punët e tij.

Tani grindjet nuk bëjnë punë. Shqipëria mbetet një shtet i akuzuar dhe një strehë për krimin. Aktakuza e rëndon atë dhe shteti duhet çliruar nga kjo aktakuzë dhe së bashku me çlirimin e tij do të saktësojë edhe të vërtetën, ashtu si ka ndodhur.

SË FUNDI:

Parashtarakët serbë kush ishin?

Në Raportin e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, Republika Federale e Jugosllavisë", 27 shtator 1999, tre muaj pas përfundimit të luftës, në shumë nga pikat e shënuara dhe të dëshmuara, përmenden parashtarakët serbë. Shumë nga masakrat e ndodhura kanë pikërisht këto ushtarakë si protagonistë ose ndihmës të afërm të makinerisë ushtarake dhe policore serbe. Në 82 raste, vetëm në tre muajt e fundit të luftës, cilësohet prania e tyre dhe çdo herë për vrasje, dhunime, grabitje, tortura, përdhunime, djegie, dëbime.

Kush janë këta?


Jo vetëm bandat e Arkanit dhe të Sheshelit, ata ishin të njohura, ashtu si grupi vrasar "Beretat e Kuqe". Ishin të aftë për krime të tmerrshme, por jo vetëm ata, e as vullnetarët rusë apo ukrainas që iu bashkuan atyre. Në shumë raste ata ishin banorë serbë të Kosovës, të cilët u uniformuan, u armatosën, menduan se ky ishte çasti i fundit i jetesës së përbashkët dhe se shqiptarët, fqinjët e tyre do të dëboheshin një herë e përgjithnjë, si u kishte premtuar Millosheviqi dhjetë vite më parë në Gazimestan.

Këto parashtarakë bënë garë me bandat e Arkanit se kush vriste më tepër, kush dhunonte më shumë, kush ishte më grabitës, kush u printe policisë serbe ndaj bazave të UÇK-së. Këto, nga strukturat e shtetit serb quheshin "grupet paramilitare që operonin me veshje civile".

Është interesant, ka vërejtur politologu i shquar Bardhyl Mahmuti, ish ministër i Jashtëm i Kosovës së pasluftës, autori i librit të shkëlqyer "Mashttrimi i madh", "se në asnjë botim të "librave të bardhë" nuk u publikua emri i ASNJË të vrari, të plagosuri, të rrëmbyeri apo të zhdukuri që ka qenë pjesëtar i grupeve paramilitare që operonin "me veshje civile".

Dhe këto, edhe pse kishin fqinjëruar me shqiptarët në dekada dhe nuk kishin pasur asnjë të keqe prej tyre, u bënë pjesë e makinerisë vrasëse. Por nuk u shpallën të vrarë në luftë, sepse do të cilësoheshin kriminelë, por më pas, duke rregulluar shifrat, u shfaqën si të rrëmbyer, të zhdukur, të vrarë barbarisht nga UÇK-ja etj. Në botimin e vitit 1999 nga qeveria serbe relatohen 32 civilë serbë dhe malazezë të vrarë nga UÇK-ja gjatë periudhës 1995-1999. Më pas, nga i njëjti institucion numri u rrit në 75 të vrarë në botimin e vitit 2000 dhe në 87 të vrarë në botimin e vitit 2001. Nga 65 civilë shqiptarë të vrarë, të cilët cilësohen në këto libra si "besnikë ndaj regjimit të Beogradit", numri i tyre një vit më pas u rrit 196, ndërsa në botimin e vitit 2001 shkoi në 230. Nga 8 civilë të vrarë, pjesëtarë të grupeve të tjera etnike, u rrit një vit më vonë në 15 për të shkuar në 18 persona. Ish-shefi i Shërbimit Sekret Serb, Radomir Marković, në kërkesën për falje të dënimit që ia drejtoi Kryetarit të Serbisë, Tomislav Nikolicit, e kërcënon se do ta rrëzojë Serbinë në gjunjë nëse publikon listën e krimeve të bëra kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Mjafton kjo për të treguar se kush i ka bërë vrasjet në Kosovë. Dhe kush duhet të jetë para Gjykatës Speciale! **(FUND)**





Friedrich Nietzsche

Çështja e Sokratit

Nga: Friedrich Nietzsche
(pjesë nga libri,
"Perëndimi i idhujve")
Përktheu: Alban BOKSHI

1.

Njerëzit më të urtë të çdo periudhe kanë arritur në të njëjtin përfundim mbi jetën: ajo nuk ia vlen ... Ngaherë e ngado, e dëgjon të njëjtin zë nga gojë të tyre – një zë përplot dyshime, përplot melankoli, përplot rraskapitje nga jeta, përplot armiqësi ndaj jetës. Bile edhe vetë Sokrati gjersa po vdiste tha: 'të jetosh – kjo do të thotë të kesh qenë i sëmurë për një kohë të gjatë. Ia kam borxh një gjel Asklep Shpëtimtarit.' [1] Edhe Sokrati i ishte bërë shumë. – Çfarë dëshmon kjo? Çfarë na tregon kjo? – Ishte një kohë kur njerëzit do të kishin thënë (– oh, njerëzit e kanë thënë, dhe mjaft zëshëm bile, sidomos pesimistët tanë): 'Duhet të ketë diçka të vërtetë këtu! Consensus sapientium (pajtueshmëria mes të urtëve) është dëshmi e të vërtetës.' – Dhe sot, a do të vazhdojmë ne të flasim kështu? A na lejohet madje kjo? 'Duhet të ketë

ndonjë sëmundje këtu' – është sesi do të përgjigjemi ne: këta më të urtë e të gjitha kohërave, le t'i shikojmë më nga afër njëherë! Ndoshta qenë bërë paksa të paqëndrueshëm në këmbët e tyre? Ndoshta ishin vonë? Po dridheshin nga pleqëria? Ishin dekadentë? Ndoshta urtësia shfaqet në tokë si korbi, e frymëzuar nga era e kafshëve të kalbura? ...

2.

Ky mendim i pacipë, që dijetarët e mëdhenj paraqesin llojin e të fishkurve, mu shfaq së pari pikërisht në atë lloj rasti të cilin paragjykimi i të diturës dhe i të paditurës po mudohej më së shumti ta pengonte: i identifikova Sokratin dhe Platonin si simptoma të kalbjes, si instrumente të shthurjes greke, si pseudo-grek, si anti-grek (Lindja e Tragjedisë, 1872). Consensus sapientium – po e shoh gjithnjë e më qartë këtë – dëshmon më së paku që më të urtët e njerëzve kishin të drejtë mbi atë rreth së cilës pajtoheshin: përkundrazi, dëshmon që ata kishin pajtim fiziologjik rreth një gjëje, dhe si pasojë përvetësuan – iu desh ta

përvetësonin – të njëjtin qëndrim negativ mbi jetën. Gjykimet, gjykimet mbi vlerën e jetës, për ose kundër saj, nuk mund të jenë asnjëherë të vërteta: ato kanë vlerë vetëm si simptoma, ato mund të merren seriozisht vetëm si simptoma – në vetvete, gjykimet e këtilla janë budallallëqe. Përpiquini ta kapni vërtet këtë finesë mahnitëse, vlera e jetës nuk mund të matet. Jo nga të gjallët të cilët janë palë interesi këtu, madje ata janë thelbi i mosmarrëveshjes e jo gjykatësi; dhe jo nga të vdekurit, për arsye të tjera. Është pikëpyetje mbi vetë filozofin nëse ai ka problem me vlerën e jetës, është pikëpyetje mbi dijet e tij, është jo-dije. – Çka? Jo vetëm që dijetarët e mëdhenj qenë të gjithë dekadentë, por nuk qenë as dijetarë? – Por më lejoni të kthehem te problemi i Sokratit.

3.

Sokrati vinte nga shtresa më e ulët e shoqërisë: Sokrati ishte plebe. Ne e dimë, dhe ende mund ta shohim sesa i shëmtuar ka qenë ai. Por shëmtia, e metë në vetvete, ishte gati e papranueshme për

grekët. A ishte madje grek Sokrati? Shëmtia shumë shpesh është shenjë e shartimit, e zhvillimit të frenuar për shkak të shartimit. Në raste të tjera shfaqet si formim në rënie. Antropologët që specializojnë në krim na thonë se kriminelit tipik është i shëmtuar: monstrum in fronte, monstrum in animo. [2] Por kriminelët janë dekadentë. A ishte Sokrati kriminel tipik? – Ky vlerësim nuk do të ishte në kundërshtim të paktën me atë gjykimin e mirënjohur fiziologjik që iu tingëlloi shumë ofendues miqve të Sokratit. Një i huaj që merrej vesh nga fytyrat, i cili po kalonte nëpër Athinë, i tha Sokratit në fytyrë që ai ishte përbindësh – që ai ishte rezervuar i të gjitha veseve dhe apetiteve të këqija. Dhe Sokrati thjesht u përgjigj: 'ju, zotëri, më njihni!' [3]

4.

Shohim shenja të dekadencës së Sokratit jo vetëm në rrëmujën dhe pështjellimin e instinkteve të tij, por edhe në logjikën e tepruar dhe smirën e ulët që e karakterizonte. Dhe mos t'i harrojmë

halucinacionet auditive të interpretuara në mënyrë fetare si 'daemoni i Sokratit'. Çdo gjë rreth tij është e tepruar, buffo (komike), është karikaturë – dhe në të njëjtën kohë, çdo gjë është e maskuar, e nëndheshme, dhe përplot motivesh të fshehta. Po mudohem të kap se çfarë qe ajo veçanti e çuditshme që i dha frymë atij ekuacioni sokratik të 'arsyes = virtutit = lumturinë': ekuacioni më bizar nga të gjithë, dhe i cili ishte në kundërshtim të plotë me të gjitha instinktet e helenëve të mëhershëm.

5.

Me Sokratin, shija greke papritmas ndryshon në favor të dialektikës: çfarë ndodhi aty në të vërtetë? Kryesorja, shija fisnike u mund; me dialektikën, turmat ngrihen në maje. Para Sokratit, mënyrat dialektike refuzoheshin nga shoqëria e lartë: ato shiheshin si të pahijshme, shiheshin si poshtëruese. Të rinjtë paralajmëroheshin që të kinin kujdes nga ajo. Njerëzit në përgjithësi ishin mosbesues kundrejt arsyeve të dhëna në

këtë mënyrë. Gjërat e ndershme, sikurse njerëzit e ndershëm, nuk sillen vërdallë me arsyet e tyre nëpër duar. Është e pahijshme të tregosh të pesë gishtat. Asgjë që ka vlerë të vërtetë nuk ka nevojë të dëshmohet. Aty ku autoriteti është ende pjesë e përbërjes shoqërore, aty ku njerëzit japin urdhra e jo arsye, aty dialektiku është tip palaçoje: ai përqeshet dhe nuk merret seriozisht. – Sokrati ishte palaçoja që bëri që ai të merrej seriozisht: çfarë ndodhi aty në të vërtetë?

6.

Dialektika zgjidhet vetëm si mjet i fundit. Dihet që do të shihet me dyshim, dihet që nuk do të jetë shumë bindëse. Asgjë nuk shkundet krahësh më lehtë sesa efekti i dialektikës: kjo dëshmohet nga përvoja me takime ku njerëzit mbajnë fjalime. Dialektika është një lloj vetëmbrojtjeje e cila përdoret vetëm nga njerëzit të cilët nuk kanë armë të tjera. Duhet të jesh në situatë ku je i detyruar të imponosh të drejtën tënde: për asgjë tjetër nuk e përdor. Kjo është arsyeja përse hebrenjtë qenë dialektikë; Rejnard Dhelpra qe dialektik: çka? edhe Sokrati gjithashtu? –

7.

– A është ironia e Sokratit shprehje revolte? e smirës prej plebeu? Si njeri i shtresave të

shtypura, a mos ndoshta Sokrati ndjente kënaqësi kur vërviste barbarisht thikën e tij silogjistike? A u hakmor ai kundër fisnikëve të cilët i magjepste? – Si dialektik, ke një armë të pamëshirshme në duar; dialektika të lejon të sillesh si tiran; t'i poshtërosh njerëzit të cilët i mund. Dialektiku e hedh barrën te kundërshtari i tij në mënyrë që të dëshmojë se ai është idiot: dialektiku i xhindos njerëzit dhe i bën të ndjehen të pafuqishëm në të njëjtën kohë. Dialektiku e gropos intelektin e kundërshtarit të tij. – Çka? Dialektika ishte vetëm një mënyrë hakmarrjeje për Sokratin?

8.

E shpjegova sesi Sokrati dinte të ishte i neveritshëm, gjë që e bën edhe më të domosdoshme ta shpjegoj faktin sesi magjepste. – Që ai e zbuloi një lloj të ri agon-i (luftë), që ai qe mjeshtri i saj i parë me skerma në rrethet fisnike te Athinës – kjo është një gjë. Ai magjepste duke e nxitur instinktin agonistik të grekëve – ai futi një variant të ri në meçet e mundjes mes burrave dhe të rinjve. Sokrati ishte një erotik i madh, gjithashtu.

9.

Por Sokrati pandehte më tepër. Ai shihte përtej athinasve të tij fisnikë; ai e kuptonte që rasti i tij, që veçantia e rastit të tij nuk

përbënte më përjashtim. I njëjti lloj degjenerimi po shtrihej heshtazi gjithandej: Athinës së vjetër po i vinte fundi. – Dhe Sokrati e kuptoi që bota kishte nevojë për të, për metodën e tij, për ilaçin e tij, për strategjinë e tij personale të vetëruajtjes . . . Gjithandej, instinktet ishin në anarki; gjithkund njerëzit ishin vetëm pesë hapa larg daljes prej kontrolli: monstrum in animo ishte rreziku i përgjithshëm. 'Instinktet duan të sillen si tiran, një kundër-tiran edhe më i fortë duhet të shpiket' . . . Kur fiziologu ia zbuloi Sokratit veten e tij si një pus apetitesh të këqija, ironiku i madh dha edhe një shenjë tjetër që na jep çelësin e vërtetë të natyrës së tij. 'Kjo është e vërtetë', tha ai, 'por unë i zotëroj ato të gjitha'. Si e zotëronte Sokrati vetveten? Në thelb, rasti i tij ishte vetëm shembulli më ekstrem dhe që binte më së shumti në sy i asaj që po shndërrohej në sëmundje të përgjithshme: njerëzit nuk ishin më të zotët e vetvetes dhe instinktet qenë kthyer kundër njëri-tjetrit. Sokrati magjepste si rasti ekstrem – shëmnia e tij që të kalte datën e ekspozonte atë para të gjithëve si të tillë. Natyrisht, ai magjepste edhe më shumë si përgjigje, si zgjidhje, si manifestim i ilaçit për këtë rast.

10.

Kur njerëzve iu duhet që arsyeja të sillet si tiran, çfarë ishte rasti

me Sokratin, rreziku nuk është i vogël që diçka tjetër mund të fillojë të sillet si tiran. Racionalja shihej si shpëtimtarja, as Sokrati dhe as 'pacientët' e tij nuk qenë racionalë sipas dëshirës – ishte de rigueur (e kohës), ishte shpëtimi i tyre i fundit. Fanatizmi me të cilin i tërë mendimi grek vrapoi pas racionale tregonte se aty kishte një krizë: njerëzit qenë në rrezik, ata kishin vetëm një zgjidhje: të shkatërrohen – ose të bëhen racionalë deri në absurditet . . . Moralizmi i filozofëve grekë prej Platonit e këndej është i kushtëzuar në mënyrë patologjike; e njëjta vlen edhe për vlerën që ata i dhanë dialektikës. 'Arsyeja = virtyti = lumturia' ka vetëm këtë kuptim: duhet ta imitosh Sokratin dhe ta realizosh gjendjen e përhershme të dritës kundrejt të gjitha dëshirave të errëta – dritën e arsyes. Duhet të jesh dredharak, i mprehtë, dhe i kthjellët me çdo kusht: çfarëdo lëshimi ndaj instinkteve, ndaj të pavetëdijshmes, çon teposhtë...


11.

E demonstrova sesi Sokrati magjepste: ai ishte si një doktor, një shpëtimtar. A është vërtet e nevojshme që t'i rendisim gabimet thelbësore të besimit të tij në 'arsyen me çdo kusht'? – Filozofët dhe moralistët e mashtrojnë veten kur

mendojnë se mund të shpëtojnë nga dekadencia duke bërë luftë kundër saj. Shpëtimi nuk është në fuqinë e tyre: çka ata zgjedhin si ilaç, si shpëtim, është në vetvete vetëm një shprehje tjetër e dekadencës – ata e ndryshojnë mënyrën sesi ajo paraqitet por nuk e heqin qafe dot atë vet. Sokrati qe një keqkuptim; i tërë moraliteti mbi përparimin, përfshirë atë të krishterë, qe një keqkuptim . . . Drita më verbuese, racionalizëm me çdo kusht, një jetë e ftohtë, e kthjellët, e kujdesshme, e vetëdijshme, pa instinkte, kundër instinkteve, qe në vetvete veç një sëmundje, veç një sëmundje tjetër – dhe assesi kthim tek 'virtyti', tek 'shëndeti', tek lumturia . . . Të detyrohesh t'i luftosh instinktet – kjo është formula e dekadencës: përderisa jeta është në ngritje, lumturia është e barabartë me instinktin.

12.

A e kuptoi ai këtë, më dredharaku nga të gjithë vetë-mashtruesit? A ia tha ai vetes këtë në fund, në urtësinë e guximit të tij përballë vdekjes? . . . Sokrati donte të vdiste: Athina nuk ia dha atij kupën me helm, ai e mori vet, ai e detyroi Athinën t'ia jepte . . . 'Sokrati nuk është doktor', tha ai qetas me vete: 'vdekja është doktori i vetëm këtu . . . Sokrati vetëm ka qenë i sëmurë për një kohë të gjatë.' /Virtual Sophists/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' nisin përgatitjet për Moldavinë, Celina rikthehet në stërvitje



PRISHTINE, 16 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll iu ka rikthyer stërvitjeve pas ndeshjes së ndaj Sllovenisë (2-1), për t'u përgatitur sa më mirë për ndeshjen e fundit në Ligën e Kombeve kundër Moldavisë, e cila zhvillohet të mërkurën në stadiumin "Fadil Vokrri". "Dardanët", në orët e mëngjesit të hënën arritën në Prishtinë, teksa në orët e mbrëmjes futbollistët që nuk luajtën dhe ata që ishin më pak të angazhuar në ndeshjen e zhvilluar në Lubjanë mbajtën stërvitje në stadiumin "Fadil Vokrri". Ndërkohë, pjesa tjetër e lojtarëve zhvilluan seancë rigjeneruese në hotel. Në ndeshjen kundër Moldavisë, Kosova nuk do të ketë në dispozicion Bernard Berishën, i cili është i pezulluar për shkak të kartonëve dhe tashmë ka udhëtuar drejt Rusisë për t'u bashkuar me klubin, por gëzon fakti se në seancën e sotme ka stërvitur

Bersant Celina, i cili mungoi në ndeshjen kundër sllovenëve për shkak të shqetësimeve me muskujt e këmbës dhe pritet që të jetë i gatshëm për lojë.

Tani e gjithë vëmendja është tek dueli me moldavët, ku synohet që me rezultat pozitiv të sigurohet mbetja në Ligën C të Ligës së Kombeve.

Kosova U21 përballet me Turqinë, synohet rezultat pozitiv

Përfaqësuesja U21 në futboll e ka zhvilluar të hënën stërvitjen e fundit para ndeshjes kundër Turqisë U21, e cila zhvillohet sot (e martë) në Samsun, në orën 17:00. Pas humbjes nga Shqipëria, të përzgjedhurit e Rafet Prekazit synojnë që ta mbyllin këtë fushatë kualifikuese me rezultat pozitiv. Në stërvitjen e fundit "dardanët" e rinj punuan me përkushtim, derisa ekziston dëshirë e madhe për të bërë lojë më të mirë se sa në ndeshjen e kaluar. Në ndeshjen e parë ndërmjet këtyre dy ekipeve që ishte zhvilluar në qershor të vitit të kaluar në Prishtinë, Kosova kishte fituar 3-1.

SHKURT

Sejdiu merr drejtimin e Vushtrrisë

Trajneri i njohur, Gani Sejdiu, e ka marrë drejtimin e skuadrës së Vushtrrisë. Sejdiu në postin e trajnerit e zëvendëson të larguarin Fitim Llapashica. "Vushtrria ka shfaqur interesim dhe pasi jam trajner i lirë dhe kanë mbetur vetëm edhe tri ndeshje deri në fund të stinorit, jam shprehur i gatshëm që ta ndihmoj", ka thënë Sejdiu. "Aty kam punuar edhe më herët dhe e njoh shumë mirë ambientin që është shumë i mirë. Pas këtyre ndeshjeve, mbetet të shihet se cilat janë planet e klubit pastaj për pranverë. Në këto ndeshje vetëm do ta ndihmoj për çfarëdo që klubi ka nevojë", ka shtuar Sejdiu, i cili në të kaluarën i ka drejtuar skuadrat si Trepça, Trepça '89, Vushtrria, Feronikeli, Ballkani, Vëllaznimi dhe Drenica.

Kastrati shënon 20 pikë kundër Mornarit

Erjon Kastrati vazhdon paraqitjet e mira në Ligën Aba. Basketbollisti i Kosovës ishte më i dalluari për skuadrën e tij, Koper Primorka, që pësoi humbje nga Mornari me rezultat 87:66. Kastrati luajti 39 minuta në këtë ndeshje dhe e mbylli ndeshjen me 20 pikë, tri kërcime dhe tri asistime, duke vazhduar me formë të mirë në këtë ligë. Primorska ndodhet në vendin e fundit me shtatë humbje nga shtatë ndeshje. Erjoni është një nga lojtarët më të dalluar të Kosovës dhe forma e tij jep shpresë edhe për përfaqësuesen e Kosovës që në fund të nëntorit do të ballafaqohet me Sllovinë dhe Islandën në kuadër të parakualifikimeve për Kupën e Botës 2023.

Norvegjia fton Veton Berishën

Lojtari shqiptar Veton Berisha është ftuar nga Kombëtarja e Norvegjisë për ndeshjen ndaj Austrisë në Ligën e Kombeve. Berisha momentalisht luan në elitën e futbollit norvegjez te skuadra e Vikingut. Ai fillimisht nuk është ftuar nga Norvegjia, por pasi që skuadra e parë kombëtare dhe stafi janë dashur të futen në izolim shkak i rasteve me Covid-19, është formuar një përbërje e re për ndeshjen e të mërkurës ndaj Austrisë. Ndeshja e Norvegjisë ishte paraparë të luhej mbrëmë (e diel) në udhëtim te Rumania, por që u anulua. Berisha ka katër ndeshje të luajtura me përfaqësuesen e Norvegjisë dhe e ka realizuar një gol. Veton Berisha është vëllai i Valon Berishës që mbron ngjyrat e Përfaqësueses së Kosovës.

Guardiola pajtohet për rinovim të kontratës, 'topi' kalon te City

MANCHESTER, 16 NËNTOR - Pep Guardiola është shumë pranë rinovimit të kontratës me Manchester Cityn, për këtë është e bindur "The Telegraph", sipas së cilës, spanjollë për herë të parë në karrierën e tij pranon një projekt të ri mbi tre vjet me

një klub. Pep nuk ua ka shprehur ende këtë dëshirë drejtuesve të klubit pasi pret fillimisht një propozim nga "qytetarët" për ta rinovuar kontratën aktuale e cila i skadon më 30 qershor 2021, në fund të këtij sezoni. Në çdo dalje publike, kur është pyetur

mbi këtë temë, Guardiola ka shprehur pëlqimin e tij, por duke qenë i qartë se më parë duhet ta meritojë në fushë. Ky fillim sezoni nuk ka qenë shumë pozitiv për Cityn, mbi të gjitha në Premierë Ligë por, ky fakt, nuk pritet t'i largojë palët. Spanjollë doli në krahë

të klubit në momentin më të vështirë kur UEFA i hoqi të drejtën të luante në Evropë, vendim që u hodh poshtë më pas në CAS, ky detaj vlerësohet shumë nga drejtuesit e klubit çfarë mund ta sjellë shumë shpejt rinovimin e kontratës.



Lojërat Olimpikë me spektatorë

TOKIO, 16 NËNTOR - Kreu i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, të hënën shprehu besimin se Lojërat Olimpikë të Tokios do të mbahen vitin e ardhshëm, madje edhe duke lejuar spektatorët të marrin pjesë, pavarësisht nga një rritje e mprehtë e numrit të njerëzve të infektuar me koronavirus në të gjithë botën, shkruan "Reuters". Vizita dyditore e Bachit në Tokio ka të ngjarë t'i forcojë përpjekjet e Japonisë për t'i mbajtur Lojërat Olimpikë, pavarësisht prej shqetësimeve të publikut për përhapjen e virusit, njoftoi agjencia e lajmeve "Fena". Bach u takua me kryeministrin e ri japonez Yoshihide Suga të hënën dhe i tha guvernatorit të Tokios, Yuriko Koike, se ata mund të jenë të sigurt se vaksina do të jetë në dispozicion deri në verën e ardhshme. KON-i do të sigurojë që vaksinimi i pjesëmarrësve dhe vizitorëve në lojëra të sigurohet para mbërritjes së tyre në Japoni, shtoi ai. "Në mënyrë që ta mbrojë popullin



japonez dhe nga respekti për popullin japonez, KON-i do të bëjë përpjekje të mëdha për t'i vaksinuar pjesëmarrësit dhe vizitorët në Lojërat Olimpikë, nëse vaksina është e disponueshme deri në atë kohë", ka thënë ai. KON-i tani është "shumë i bindur" se spektatorët do të jenë në gjendje t'i ndjekin lojërat. Temat kryesore të diskutimit të tij me

organizatorët e lojërave përfshijnë nëse prania e spektatorëve do të lejohet dhe çështja e akomodimit të më shumë se 11 000 atletëve, të cilët vijnë nga e gjithë bota. Vizita e Bachit është e para në kryeqytetin japonez qëkur ai dhe ish-kryeministri Shinzo Abe vendosën në mars t'i shtyjnë lojërat 2020 për një vit.

SHKURT

Mayweatheri vitin e ardhshëm rikthehet në ring

Boksieri Floyd Mayweather do të rikthehet në ring për luftë më 28 shkurt 2021 në Tokyo Dome. Boksieri i pensionuar me rekordin e mahnitshëm 50-0, njoftoi se do të bëjë diçka të madhe. Detajet për kundërshtarin nuk dihen, mirëpo u konfirmua se Mayweather do të rikthehet në ring. Mayweather në konferencë për shtyp konfirmoi se do të rikthehet në Tokio, meqenëse ka dashuri të madhe për japonezët. "Japonia është ndër shtetet më të bukura në botë. Tokio është, gjithashtu, qytet i mrekullueshëm. Dua t'i kënaq njerëzit japonezë. Stërvitem shumë. Dua të përgatitem mirë këtë herë. Dua t'i falënderoj të gjithë tifozët japonezë dhe tifozët e Tokios. Faleminderit që më kujtoni!", ka thënë Mayweather. "Nuk kam ide me kë do të përballim. Jam duke u përgatitur. Është vend që organizohen ndeshjet e mira, pra dua të arrij në Japoni që t'i kënaq tifozët", ka shtuar ai. Mbetet të shihet kush do jetë kundërshtari i Mayweatherit.

Ramosi merr ofertë të "çmendur" nga PSG-ja

Sergio Ramos pritet të larohet nga Real Madridi për ta vazhduar karrierën në një tjetër skuadër. E sigurt për këtë është e përditshmja madrilene "AS". Sipas saj, kapiteni dhe klubi "los blancos" janë shumë larg rinovimit. Kontrata e Ramosit skadon më 30 qershor, kurse Reali pranon ta zgjasë bashkëpunimin edhe për një tjetër vit, por duke përfshirë disa klauzola dhe sigurisht ulje të përfitimeve të futbollistit. Kjo nuk pranohet nga mbrojtësi, që për të qëndruar në skuadër pretendon të paktën një kontratë dyvjeçare. PSG-ja është gati t'i plotësojë këto kushte duke përfshirë kontratën trevjeçare.

Suarezi: Ndiem keq kur vuan Barça

Barcelona e largoi Luis Suarezin, por sulmuesi nuk e ka humbur dashurinë për klubin nga "Camp Nou". "Ishte një planifikim i ri taktik dhe më duhej ta pranoja se nuk kishin nevojë për mua. Secili nxjerr përfundimet e veta. Unë tani duhet të jetoj të tashmen tek Atletico, por kjo nuk do të thotë se nuk ndihem keq kur shoh Barçën të luajë keq. Kam lënë shumë shokë atje dhe i ndjek me kujdes. Po e vuaj atë mungesë force të tyre. Megjithatë, janë në rrugën e duhur kur të vijnë në nivelin e duhur do të jenë në luftë për gjithçka. Me Messin flasim dhe takohemi shpesh. Flasim për jetën, për virusin, por shumë pak për futbollin", ka thënë Suarez.

Fitorja ndaj Bjellorusisë ia siguron Shqipërisë vendin e parë në grup dhe mbi 1 milion euro

TIRANË, 16 NËNTOR - Shqipëria mori të dielën në mbrëmje një fitore ndaj Kazakistanit, që e mban ende në garë për vendin e parë në grupin 4 të Ligës C në Ligën e Kombeve. Tashmë kuqezinjët duhet ta mposhtin Bjellorusinë po në "Air Albania" të mërkurën për ta realizuar objektivin dhe për ta siguruar vendin e parë në grup, një vend i parë që jo vetëm do ta ngjisë Shqipërinë në Ligën B për edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve. Gjithashtu, do të pozicionohet në një vazo më të lartë për shortin e eliminatoreve të Botërorit Katar 2022 dhe njëkohësisht do t'u garantojë arkave të Federatës Shqiptare të Futbollit shumën e 1 milion e 125 mijë eurove që UEFA ua jep



skuadrave që fitojnë grupet në Ligën C, para që mund t'i shërbejnë Federatës për të ardhmen e

ekipit kombëtar. Ndeshja Shqipëri - Bjellorusi do të luhet të mërkurën në orën 16:00.

Pensionohet Mascherano

Javier Mascherano ka njoftuar se do të pensionohet nga futbollit pasi e shijoi një karrierë të bujshme 17-vjeçare në Amerikën Jugore dhe në Evropë. Mascherano e nisi karrierën profesionale me River Platen në

vitin 2003 dhe e kaloi një vit në Brazil te Corinthians para se të kalonte në Premierligë. Mascherano e kaloi një periudhë të shkurtër te West Hami, e pastaj tri vjet në Liverpool nga ku iu bashkua Barcelonës, klubit me të

cilin e kaloi periudhën më të suksesshme në karrierë. Pasi i fitoi pesë tituj në La Liga dhe dy trofe në Ligën e Kampioneve në mesin e shumë trofeve të tjerë gjatë tetë vjetëve në "Camp Nou", ai u josh nga Hebei China

Fortune. 36-vjeçari u rikthye në Argjentinë në janar duke iu bashkuar Estudiantes, me të cilin kishte kontratë deri në fund të këtij sezoni. Megjithatë, Mascherano ka vendosur t'i varë këpucët në gozhdë tani. "Ka

ardhur koha t'i jap fund karrierës për shkak të gjërave që më ndodhën në muajt e fundit në jetën personale dhe pasi e kam menduar mirë këtë, kam vendosur që është e drejtë t'i jap fund sot", ka thënë Mascherano.

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirim kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhësi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË
(1990-1991)




“A po shkruan Barney?”
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
 “A po të shiten librat?”
 “Po marrë çeçe nga të drejtat e autorit”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”
 “Për femrat moderne”.
 “Për femrat moderne?!”
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrsisht të këqija”.
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkiten dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €




Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI
EMANCIPIMI I GRUAS


Përktheu: Fadil Bajraj





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shkelzen Gashi shpall te pa vlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha" ne Gjakovë.

► Fisnik Mamusha shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.E. " Kadri Kusari " ne Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

